




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.385/2023

Datë: 28 korrik 2023

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, paragraf 1, pika 1.14, të Ligjit 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Lidija Vuquroviq, gjyqtare në Gjykatën e Apelit, Divizioni në Mitrovicë, sipas raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/24/2022/GJA-ADGJA.nr.12/22, të datës 16 mars 2023, në pajtim me Ligjin 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2023 merr këtë:

## V E N D I M

1. Lidija Vuquroviq, gjyqtare në Gjykatën e Apelit, Divizioni në Mitrovicë, është përgjegjëse për shkelje disiplinore të përcaktuar në nenin 5, paragraf 1, pika 1.2 dhe 1.3, lidhur me paragrafin 2, pika 2.16 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
2. Për këtë shkelje disiplinore, gjyqtares Lidija Vuquroviq, i shqiptohet sanksioni disiplinor **vërejtje publike me shkrim**.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje “Këshilli”), me datë 13 dhjetor 2022, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent me pretendimin se gjyqtarja Lidija Vuquroviq, bazuar në lajmin e publikuar në portalin “Kallxo.com” mund të ketë bërë shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 5, paragrafi 1, pika 1.2, 1.3 dhe paragrafi 2, pika 2.16 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, andaj ka kërkuar nga Këshilli fillimin e hetimit disiplinor.

Kërkesës së lartëcekur Autoriteti Kompetent i ka bashkangjitur fotografitë e publikuara në portalin “Kallxo.com”, me mbishkrimin “Pjesëmarrja e gjyqtarëve në takimin e Listës Serbe”, e datës 5 nëntor 2022, si dhe shkresat e disa prej mediave tjera të vendit me titull “Zyrtarët e lartë të drejtësisë pjesëmarrës në takimin e Listës Serbe”.

Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, ka themeluar panelin hetimor, i cili panel brenda afatit ligjor ka përfunduar hetimin disiplinor. Paneli hetimor për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore me datë 3 mars 2023, në të cilën ka prezantuar edhe subjekti i hetimit disiplinor, dhe pas përfundimit të hetimit, raportin me faktet dhe provat e mbledhura, i'a ka dorëzuar Këshillit duke kërkuar që bazuar nga këto prova të vendos se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarës Lidija Vuquroviq.

Këshilli pas pranimit të raportit nga paneli hetimor për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore ka mbajtur seancë dëgjimore me datë 18 maj 2023, në të cilën kanë prezantuar kryesusi i panelit hetimor gjyqtari Fatmir Dobraj dhe subjekti i hetimit gjyqtarja Lidija Vuquroviq.

Kryesusi i panelit hetimor në seancën dëgjimore në Këshill, deklaroi se bazuar në të gjeturat e panelit, është e pakontestueshme që subjekti i hetimit ka marrë pjesë në takimin e datës 5 nëntor 2022, mirëpo si fakt kontestues ka përmendur atë që subjekti i hetimit nuk ka qenë në dijeni për natyrën e takimit dhe kush e ka organizuar takimin në fjalë. Sipas të gjeturave të panelit dhe deklaratave të subjektit të hetimit ajo është ftuar për pjesëmarrje në takimin konkret dhe se sipas saj qëllimi i takimit ka qenë se si do të veprojnë në të ardhmen si gjyqtarë të komunitetit serb. Në fund, kryesuesi i panelit kërkoi nga Këshilli që bazuar në këto të gjetura dhe konkluzione të panelit të vendos se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga ana e subjektit disiplinor znj. Lidija Vuquroviq.

Subjekti i hetimit disiplinor znj. Lidija Vuquroviq, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 18 maj 2023, para Këshillit ka deklaruar se qëndron pranë gjitha deklaratimeve që i ka dhënë te paneli hetimor. Më tutje, znj. Vuquroviq, theksoi se është e vërtetë që ka marrë pjesë në takimin e datës 5 nëntor 2022, mirëpo nuk ka qenë në dijeni për natyrën e takimit dhe kush është organizator, por vetëm është ftuar që të merr pjesë në këtë takim urgjent sepse i është thënë se do të diskutohet lidhur me punën e tyre si gjyqtar të komunitetit serb në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës. Gjyqtarja Vuquroviq më tutje deklaroi se në përvojën e saj të gjatë si gjyqtare asnjëhere nuk ka qenë e angazhuar në ndonjë aktivitet të natyrës politike.

Paneli hetimor raportit mbi faktet dhe provat e mbledhura, i ka bashkangjitur këto prova: Fotografitë e paraqitura nga "Kallxo.com", me mbishkrimin "Pjesëmarrja e gjyqtarëve në takimin e "Listës Serbe", e datës 30 nëntor 2022, si dhe shkresat e mediave tjera të vendit me titull "Zyrtarët e lartë të drejtësisë pjesëmarrës në takimin e Listes Serbe" dhe Procesverbalin e seancës dëgjimore të panelit hetimor të mbajtur me datë 3 mars 2023.

Këshilli administroi dhe vlerësoi të gjitha provat që paneli hetimor i ka bashkangjitur raportit me shkrim dhe konstatoi se bazuar edhe në deklaratën e subjektit të hetimit, që e njëjta nuk ka qenë në dijeni për natyrën politike të takimit të "Listës Serbe", por përmes telefonit i është thënë që duhet të merr pjesë urgjent në takim, ku do të diskutohet lidhur me vazhdimin e tyre të punës si gjyqtar të komunitetit serb. Për Këshillin nuk është kontestuese pjesëmarrja e subjektit të hetimit në takimin e datës 5 nëntor 2022, sepse është dokumentuar me prova dhe fotografi ku shihet qartë pjesëmarrja e subjektit të hetimit, mirëpo ka vlerësuar se edhe pse gjyqtarja nuk ka qenë në dijeni për natyrën e takimit, e njëjta ka mundur të tërhiqet nga takimi kur e ka kuptuar se nga kush është organizuar takimi, në mënyrë që kjo të mos ndikojë në besimin e publikut për pavarësinë e gjyqtarit.

Përgjegjësia e gjyqtarit sipas vlerësimit të Këshillit lidhet me sjelljen e tij dhe në promovimin e besimit të publikut ndaj gjyqësorit, që rrjedhin nga dispozitat e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar. I njëjti kod sqaron se gjyqtari duhet të ruaj dhe promovojë integritetin e figurës së gjyqtarit.

Në rastin konkret Këshilli vlerëson se gjyqtarja Vuquroviq, me pjesëmarrjen e saj në takimin e organizuar nga përfaqësues të partisë politike, ka konsumuar të gjitha elementet e shkeljeve etike. Raporti i panelit hetimor sipas Këshillit është vlerësuar si i besueshëm pasi që paneli në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve. Këshilli i ka vlerësuar pretendimet e subjektit të hetimit, por ka gjetur se në kuptim të fakteve të konstatuara me provat e administruara, këto pretendime dhe deklarata nuk kanë ndikuar që Këshilli të marr një vendim tjetër.

Masa disiplinore e shqiptuar, sipas vlerësimit të Këshillit në rrethanat aktuale është masë adekuate në raport me shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit, pasi që në rastin konkret ka qenë e pamundur të aplikohet masa e zbritjes së pagës duke qenë se subjekti i hetimit është gjyqtar që ka deklaruar dorëheqjen, ndërsa masa tjera janë konsideruar jo proporcionale përveç masës së vërejtjes publike, andaj në këtë mënyrë është siguruar zbatimi i përgjegjësiave ligjore që ka Këshilli në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve, e cila procedurë bazohet në Ligjin 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sipas të njëjtit ligj, masa disiplinore duhet të jetë e tillë që të ndikojë te gjyqtari që është subjekt i hetimit me qëllim të korrektimit të veprimeve të tij/saj, gjatë ushtrimit të funksionit në të ardhmen.

Nga sa u tha më lartë, bazuar në nenin 7, paragrafi 1, pika 1.2, dhe paragrafi 2, pika 2.5 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.385/2023, datë 28 korrik 2023**

  
Albert ZOGAJ  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

**Këshill juridike:**

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij vendimi.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- z. Valon Totaj, kryetar i Gjykatës së Apelit.
- Z. Lidija Vuquroviq, gjyqtare në Gjykatën e Apelit, divizioni në Mitrovicë.